

□

LËNDA:

Rregullat zyrtare
Të Lojës shpërblyese "Ditëlindja e 13-të e Ramstor!"

Neni 1

EMRI ZYRTAR I LOJËS SHPËRBLYESE

Emri zyrtar i Lojës shpërblyese është "Ditëlindja e 13-të e Ramstor!".

Organizues i lojës shpërblyese: Ramstor Maqedoni SHPK, me seli në rr. Sh. Qirili dhe Metodij nr.13, Shkup (në tekstin e mëtejshëm Organizuesi).

Neni 2

KOHËZGJATJA E LOJËS SHPËRBLYESE

Loja shpërblyese do të organizohet në periudhën prej 04.10.2018 -
21.11.2018

Neni 3

QËLLIMI I LOJËS SHPËRBLYESE / ORGANIZUESI

Qëllimi i kësaj loje shpërblyese është reklamimi i prodhimeve dhe shërbimeve në të gjitha Ramstore marketët në Shkup, Tetovë, Kumanovë, Kërçovë, Ohër, Strugë, Strumicë.

Neni 4

PËRSHKRIMI I LOJËS SHPËRBLYESE

Neni 4.1

Territori i lojës shpërblyese

Loja shpërblyese do të realizohet në të gjitha Rsmstore marketët në Shkup, Tetovë, Kumanovë, Kërçovë, Ohër, Strugë, Strumicë në këto adresa:

- rr. "Qirili dhe Metodi" nr.13 – **marketi Vardar**
- rr. "Vidoe Smilevski-Bato" nr.10-a – **marketi Lisiçe e Re**
- rr. "Boris Trajkovski" nr.64 – **marketi Kisella Vodë**
- rr. "Februarski pohod" nr. 46 – **marketi Lisiçe e Epërme**
- bul. "Jane Sandanski" nr. 71a – **marketi Kapitoll**
- rr. "Vasil Gorgov" 20a – **marketi Kapishtec**
- rr. "Lazo Trpovski" nr.5 – **marketi Çair**
- rr. "Marshali Tito" p.n. – **marketi Tetovë 1**
- rr. "Marshali Tito" nr. 21 – **marketi Tetovë 2**
- rr. "Van Vardarska" nr. 1 – **marketi Tetovë 3**
- rr. "Shën Klimenti i Ohrit" nr. 1 – **marketi Ohër**
- rr. "Marshali Tito" nr. 116a – **marketi Strugë**
- rr. "Brigada e Tretë Maqedonase" nr.68, – **marketi Kumanovë**
- rr. "Todor Aleksandrov" nr. 83 Shkup – **marketi Vodno**
- rr. "Brigada Proletare" nr. 20 – **marketi Struga ekspres**
- rr. "Bllagoj Davkov" nr.2 - Qendër Shkup – **marketi Debar mallo**
- Bulevardi "Osloboduvanje" nr.1 / Kërçovë – **marketi Kërçovë**
- rr. "Milan Zeçar" nr. 6 - **Aerodrom**
- rr. "Lubjanska" nr. 4 Karposh – **Siti moll**
- rr. "Dame Gruev" nr.1 hyrja 1 – **Kuvendi**
- rr. "Hristijan Todorovski Karposh" nr. 97 – **Kumanovë Ekspres**
- rr. "Jane Sandanski" nr. 98 A Ohër – **Ohër Ekspres**
- rr. "Bllagoj Jankov-Muçeto" nr.16 Strumicë – **Strumicë**
- rr. "Moskovska" p.n. Karposh – **Taftalixhe**
- rr. "Brigada e Dytë Maqedonase" nr.23 – **Veri Çair**
- rr. "20" nr.69 - **Saraj**

Neni 4.2

RREGULLAT PËR PJESËMARRJE NË LOJËN SHPËRBLYESE

Loja shpërblyese "Ditëlindja e 13-të e Ramstor!" fillon më 04.10.2018 në ora 08:00 dhe përfundon më 21.11.2018 në ora 22:00.

1. Të drejtë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese kanë të gjithë blerësit e moshës madhore, llogaritë fiskale të cilëve kanë vlerë mbi 1.000 denarë.
2. Kohëzgjatja e lojës shpërblyese është prej 04.10.2018 deri më 21.11.2018. Në lojën shpërblyese do të marrin pjesë llogaritë fiskale të lëshuara në periudhën prej 04.10.2018 deri më 21.11.2018 – prej orës 08:00 deri në ora 22:00
3. Nëse ekzistojnë llogari fiskale të lëshuara pikërisht deri në ora 22:00 më datën 21.11.2018, të njëjtat do të merren parasysh dhe do të kenë të drejtë për pjesëmarrje më së voni deri në ditën tjetër deri në ora 12:00 në info pikat e vendosura në çdo Ramstore market ku do të jepen kuponë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese.

4. Tërheqja e shpërblimeve do të mbahet më 03.12.2018 në ora 12:00 në QT Ramstor Moll para marketit, ndërsa do të kontrollohet nga komisioni i përbërë nga një përfaqësues i Ramstore dhe noterit.
5. Llogaria fiskale e shfrytëzuar një herë, nuk mund të marrë pjesë përsëri në lojën shpërblyese.
6. Fondi i shpërblimeve për periudhën e caktuar është i kufizuar dhe përbëhet prej: 1 (një) shpërblim kryesor – 1,000,000.00 denarë, shpërblimi i 2-të 30,000.00 denarë do të fitojnë 13 fitues dhe 113 fitues do të marrin nga 3,000.00 denarë, gjegjësisht fondi i përgjithshëm i shpërblimeve është 1,729,000 denarë.
7. Çdo pjesëmarrës në lojën shpërblyese, me vetë pjesëmarrjen pajtohet se nëse tërhiqet si fitues të ndonjërit nga shpërblimet, që emri dhe mbiemri i tij të publikohet në ueb faqet zyrtare të Ramstore Maqedoni.
8. Shpërblimet mund të merren menjëherë me nënshkrimin e marrëveshjes me Ramstore, ndërsa më së voni deri 60 ditë nga dita e tërheqjes, në zyrat administrative të Ramstore Maqedoni, rr. Sh. Qirili dhe Metodi nr.13, Shkup, ndërsa transferimi i shpërblimit mund të bëhet më së shumti 5 ditë pune nga nënshkrimi i marrëveshjes.
9. Shpërblimi i fituar, nuk mund të zëvendësohet me tjetër dhe nuk ekziston lloj tjetër i kompensimit.
10. Pjesëmarrësit paraprakisht pajtohen me rregullat e lojës shpërblyese të përshkruara në nenin 6 këtu.
11. Të gjithë të punësuarit në Ramstore SHPK, si dhe anëtarët e familjeve të tyre më të ngushta nuk mund të marrin pjesë në lojën shpërblyese. Nëse marrin pjesë dhe fitojnë, shpërblimin nuk do të jepet.
12. Në rast të parregullsive dhe mos përmbajtjes ndaj rregullave të caktuara, organizuesi Ramstor Maqedoni e mban të drejtën ta diskualifikojë pjesëmarrësin.
13. Mënyra e pjesëmarrjes në lojën shpërblyese:

Hapi 1

Të dorëzojë llogarinë fiskale me vlerë të barabartë ose më të lartë se 1000 denarë të bëra në Ramstore marketët në info pikat, gjatë së cilës do t'i jepet kupon shpërblimi. Kuponi duhet të plotësohet nga ana e konsumatorit me këto të dhëna personale: Emri dhe mbiemri, adresa dhe telefoni për kontakt dhe të hedhura në kutitë e shënuara dhe të vendosura në vend të dukshëm në marketët.

Për llogari të bërë prej 1000.00 denarë ose më shumë dhe shfrytëzohen pikët dhe me këtë zvogëlohet llogaria nën 1000.00 denarë pjesëmarrësi nuk i plotëson kushtet që të fitojë kupton dhe të marrë pjesë në lojën shpërblyese.

Sqarim:

- Për llogari prej 1000 deri më 1999 denarë, konsumatori fiton një kupon shpërblyes
- Për llogari prej 2000 deri 2999 denarë, blerësi fiton dy kuponë shpërblyes
- Për llogari prej 3000 deri 3999 denarë, blerësi fiton tre kuponë shpërblyes etj., do të thotë për çdo 1000 denarë shtesë fitohet nga një kupon shpërblyes

Hapi 2

Pas verifikimit të kryer të llogarisë/ve fiskale, personi përgjegjës i jep numrat e caktuar të kuponëve shpërblyes.

Hapi 3

Konsumatori do të duhet t'i plotësojë të gjitha të dhënat në kuponët shpërblyes, të njëjtit t'i hedh në kutitë më së voni deri më 21.11.2018 deri në ora 22:00 dhe t'i ruajë llogaritë fiskale të cekura në kuponin shpërblyes deri në përfundimin e tërheqjes.

Pas mbylljes së kutive të vendosura në çdo Ramstore market, kutitë prej të gjithë marketëve të ramstore do të transferohen në lokacionin e caktuar, ku do të bëhet tërheqja, pas çka të gjithë kuponët do të hidhen në një enë të madhe prej ku do të bëhet tërheqja në Qendrën tregtare Ramstore Moll, para marketit.

Hapi 4

Më 03.12.2018 në ora 12:00 në Ramstor Moll, që gjendet në rr. Sh. Qirili dhe Metodi nr.13, Shkup para marketit, do të bëhet tërheqja publike e shpërblimeve në prezencë të dy anëtarëve të komisionit të përbërë prej noterit dhe një përfaqësuesi të Ramstore Maqedoni. Tërheqja do të bëhet me dorë nga ana e një ose dy hostesave.

Neni 4.3

Mënyra e dorëzimit të shpërblimeve

- Tërheqja do të jetë publike.
- Tërheqja e shpërblimeve do të bëhet më 03.12.2018 në ora 12:00.
- Në mënyrë plotësuese do të tërhiqen 16 fitues potencial të cilët do të regjistrohen në listë të veçantë për fituesit plotësues potencial.

- Nëse dikush nga fituesit do të jetë prezent në tërheqjen publike, pranimi i shpërblimit mund të bëhet menjëherë pas kontrollimit të besueshmërisë së të dhënave
- Secili nga fituesit do të informohet përmes telefonit nga ana e Organizuesit për shpërblimin e fituar dhe të njëjtin mund ta marrë në afat prej 60 ditëve nga dita e tërheqjes, në zyrat administrative të Ramstore Maqedoni në rr. Shën Qirili dhe Metodij nr. 13, Shkup.
- Pas skadimit të afatit të paraparë, Organizuesi nuk ka kurrfarë përgjegjësie rreth shpërblimeve.
- Fituesi i shpërblimit gjatë pranimit të shpërblimeve duhet të prezantojë dokument valid për identifikim (letra e njoftimit, pasaporta, leja e vozitjes) dhe t'i prezantojë llogaritë fiskale të cekura në kuponin shpërblyes. Nëse gjatë identifikimit të fituesit vërtetohet se nuk i plotëson kushtet për pjesëmarrje në lojën shpërblyese në pajtim me rregullat e cekura, shpërblimi do t'i jepet fituesit të ardhshëm, i cili gjendet në listën plotësuese të fituesve potencial.
- Nëse fituesi dhe të gjithë fituesit plotësues potencial e humbin të drejtën e shpërblimit, i njëjti llogaritet se nuk është pranuar dhe mbetet në pronësi dhe dispozicion të Organizuesit.
- Dorëzimi do të bëhet me dorëzimin personal të shpërblimit kryesor dhe shpërblimet tjera në zyrat administrative të Ramstore Maqedoni. Publikimi i fotografisë ose fytyrës së fituesit në fotografi, audio dhe video incizime ose pjesëmarrje në opinion për qëllim të reklamimit të Organizuesit lidhur me lojën shpërblyese, do të jetë lëndë e pëlqimit plotësues të fituesve, për çka fituesit nuk kanë të drejtë për kompensim plotësues.
 - Ramstore do t'ia paguajë tatimin personal fituesit.
 - Fituesi nuk mund ta transferojë shpërblimin ndonjë personi tjetër, organizate ose institucioni.
 - Lista e fituesve dhe vlera e shpërblimeve do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Ramstore Maqedoni www.ramstore.com.mk, menjëherë pas tërheqjes dhe së paku në një gazetë ditore që distribuohet në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, më së voni në afat prej shtatë ditëve nga dita e tërheqjes.

Neni 4.4

Përgjegjësia

- Fondi i përgjithshëm shpërblyes do të sigurohet nga ana e organizuesit.

- Organizuesi do të jetë përgjegjës deri në momentin e pranimit të shpërblimit nga ana e fituesve.
- Me pagesën e tatimit personal dhe pranimin e shpërblimit, ndërpriten obligimet e mëtejshme të Organizuesit të lojës shpërblyese ndaj fituesve. Organizuesi nuk ka kurrfarë përgjegjësie e cila mund të dale nga shfrytëzimi i shpërblimeve, si dhe pagesa në bazë të dëmeve ose padive të cilat në ndonjë mënyrë kanë të bëjnë me shfrytëzimin e shpërblimeve.

Neni 5

TË DREJTË Pjesëmarrjeje në lojën shpërblyese

Të drejtë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese ka secili person fizik i moshës madhore (me 18 vjet të plota), përveç personave të cilët janë të punësuar te Organizuesi Ramstore Maqedoni SHPK dhe anëtarët e familjeve të tyre më të ngushta (prindërit dhe fëmijët, motra, vëllai, bashkëshorti ose bashkëshortja).

Neni 6

Lajmërim për pjesëmarrësit për rregullat zyrtare

Rregullat zyrtare të lojës shpërblyese pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave para fillimit të lojës shpërblyese, do të publikohen në ueb faqen e Organizuesit www.ramstore.com.mk, si edhe në pikat informative në çdo Ramstore market.

Pjesëmarrësit në Lojën shpërblyese, për Rregullat zyrtare të lojës do të mund të informohen përmes materialeve informative-reklamuese, të cilat do të vendosen në vende të dukshme në çdo Ramstore market, mediat e shtypura dhe elektronike (televizione, radio, portale, baner, poster, fletëpalosje etj.).

Neni 7

Fondi shpërblyes

Neni 7.1

Shpërblime të lojës shpërblyese

Fondi i shpërblimeve përbëhet prej:

| EMRI | VLERA INDIVIDUALE | SASIA | VLERA E PËRGJITHSHME |
|--------------------|-------------------|-------|----------------------|
| Shpërblimi kryesor | 1,000,000.00 | 1 | 1,000,000.00 |
| Shpërblimi II | 30,000.00 | 13 | 390,000.00 |

| | | | |
|----------------|----------|-----|------------|
| Shpërblimi III | 3,000.00 | 113 | 339,000.00 |
|----------------|----------|-----|------------|

Neni 8

OBLIGIMET TATIORE PËR FITUESIT E SHPËRBLIMEVE

Obligimet tatimore për fituesit e shpërblimit i paguan Organizuesi i Lojës shpërblyese në emër dhe për llogari të fituesit.

Neni 9

KONTESTET TË CILAT DO TË MUND TË PARAQITEN NGJATË LOJËS SHPËRBLYESE

Gjatë Lojës shpërblyese mund të vijë deri te kontesti mes Organizuesit dhe pjesëmarrësve në Lojën shpërblyese. Kontesti mund të ndodh në rast se ndonjë nga palët e cekura nuk i përmbahet Rregullave zyrtare të Lojës shpërblyese të cilat janë arsyetuar më sipër. Në rast të çfarëdo kontesti mes Organizuesit dhe Pjesëmarrësve në lojën shpërblyese, kontesti i tillë do të zgjidhet në bazë paqësore.

Neni 10

AFATI PËR PARASHTRIMIN E ANKESËS

Çdo pjesëmarrës ka të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditë nga dita e përfundimit të lojës shpërblyese.

Ankesa parashtrohet deri te Organizuesi i Lojës shpërblyese.

Organizuesi i Lojës shpërblyese do t'i përgjigjet ankesave në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimin të njëjtës.

Ramstore Macedonia DOO

Drejtor
Ajhan Uzun
